




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shërbimeve Publike - Ministarstva Javnih Sluzbi - Ministry of Public Services

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Ambientit

Anketa e Mbeturinave Komunale 2007



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shërbimeve Publike - Ministarstva Javnih Sluzbi - Ministry of Public Services

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Ambientit

Anketa e Mbeturinave Komunale 2007



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)

Data e botimit: Dhjetor 2008

© : Enti i Statistikës së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ESK-së
në internet: www.ks-gov.net/esk

Hyrje

Është hera e parë që Enti i Statistikës së Kosovës, konkretisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit ka realizuar Anketën e Mbeturinave Komunale.

Qëllimi i kësaj ankete është që të siguroj të dhëna statistikore të qëndrueshme për sektorin e mbeturinave Komunale në Kosovë.

Rezultatet e Anketës së Mbeturinave Komunale 2007, të prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen e tanishme të këtij sektori.

Të gjitha instrumentet statistikore që janë përdorur për realizimin e anketës janë në harmoni me rregulloret dhe rekomandimet e BE, duke përfshirë edhe Ligjin e Mbeturinave në Kosovë (Nr .02/L-30).

Falenderimet kryesisht iu dedikohen Statistikave Suedeze për ofrimin e asistencës teknike, si dhe Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), eksperteve të Statistikave Suedeze Zotit Peter Worwerk Zonjes Anna Hjerne dhe konsultantes afatëgjate të Statistikave Suedeze Zonjës Milva Ekonomi.

Ky publikim është përgatitur nga personeli i Departamentit të Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në ESK :

Bajrush Qevani, Drejtor DSBM.

Mr.sc.Haki Kurti, Shef DSBM

Arta Salihu-Morina, Zyrtare DSBM

Çdo sugjerim, propozim apo vërejtje për këtë publikim është i mirëpritur dhe do të na ndihmojë ta begatojmë përmbajtjen e publikimit në të ardhmen.

Dhjetor, 2008

Kryeshef Ekzekutiv,
Avni Kastrati

Shkurtesat dhe Akronimet

BE	Bashkimi Evropian
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
AKMM	Agjensioni Kosovar i Mbrojtjes së Mjedisit
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
ZRRUM	Zyra Rregullatore e Ujit dhe Mbeturinave
KKP	Kompanite Komunale Publike
DMD	Derë me Derë
BK	Banesa Kolektive
SL, 2007	Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2007
DSBM	Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
DPSIR	Treguesit, Presioni, Gjendja, Indikatorët, Pergjegjesit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
EEA	Agjensioni Evropian për Mjedis

Simbolet

Kg/person	Kilogram për person
kg	Kilogram
t	Tonë
%	Përqindje

P ë r m b a j t j a

	Faqe
Objektivat, metodologjia e anketes	4
Metodologjia	4
Procedurat ne terren.....	5
Definicionet	5
Rezultatet.....	6
Tabela 1	6
Tabela 2	8
Aneks 1 Pyetësoni.....	11

Të dhënat e përgjithshme

Anketa e mbeturinave Komunale për vitin 2007, është realizuar sipas modelit DPSIR, i cili është i adoptuar nga grupi i shteteve të OECD-se, EUROSTAT, Agjencionit Evropian për Mjedis (EEA) dhe gjithashtu bazuar në regjistrin e indikatorëve mjedisor sipas EEA

1. Objektivat, metodologjia e anketës

1.1 Objektivat

Objektivi i anketës së mbeturinave komunale, 2007 është që të sigurojë të dhëna statistikore për mbeturinat komunale sipas; Vëndit të gjenerimit të mbeturinave dhe sasis së mbeturinave të grumbulluara sipas vëndit të hedhjes.

Gjithashtu ka pasur për qëllim që të siguroj bazen e monitorimit të mbeturinave komunale në të ardhmen në këtë sektor.

1.2 Metodologjia

1.2.1 Korniza e anketës

Në periudhën Korrik – Gusht 2007 janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për ankete duke filluar nga:

Përgatitja e pyetësorit, udhëzuesit, testimi të pyetësorit në kompani publike që merren me menaxhim të mbeturinave komunale, mbajtja e trajnimeve për personelin e angazhuar në anketë.

Janë zgjedhur 14 kompani nga regjistri i komunave përkatëse, si dhe janë bërë krahasimet me dokumentet tjera shtesë nga ZRRUM dhe MMPH-AKMM.

1.2.2 Procedurat ne terren

Puna në terren është realizuar nga bashkëpunorët tanë në zyret rajonale, të cilet kanë zhvilluar intervista të drejperdrejta me menaxheret e kompanive në rajonin e tyre, duke u bazuar në pyetësore (Aneksi1).

Kontrollimi i të dhënave është bërë ne tre nivele:

- (i) Kontrollimi i pyetësoreve të kompletuar në terren nga mbikqyresit e terrenit.
- (ii) Kontrollimi i pyetësoreve te kompletuar në zyren qendrore në ESK, nga stafi i Departamentit te Bujqësisë dhe Mjedisit
- (iii) Kontrollimet logjike gjatë përfshirjes së të dhënave në programin e pergatitur enkas për këtë qëllim nga sektori i TI dhe nga ekspertet Suedez.

2. Definicioni

Mbeturinat Komunale janë mbeturina të grumbulluara dhe të trajtuara nga kompanitë qe merën me menaxhim të mbeturinave komunale. Në këtë kategori përfshihen mbeturinat nga ekonomitë familjare, mbeturina të ngjashme nga aktivitet tregtare, institucionet dhe bizneset e vogla, mbeturina të oborrit dhe kopshteve, plehrat e rrugëve, mbeturinat qe vijnë nga përmbajtja e kontejnerëve të mbeturinave dhe mbeturinat e rënda.

Gjithashtu përfshihen mbeturinat nga rrjeti komunal i ujerave të zeza dhe përpunimi, ndërtimet e objekteve komunale dhe mbeturinat e rrënimëve në ndërtimtari.

3. Rezultatet

Tabela 1. Sasia e mbeturina komunale te grumbulluar sipas vendit te hedhjes

	Banesa kolektive [1000 ton]	Derë me Derë [1000 ton]	Gjithsej [1000 ton]
Prishtina & regjioni*	88	94	182
Regjionet tjera në Kosovë	56	92	148
Gjithsej	144	186	330

Sasia totale e mbetjeve komunale në Kosovë për vitin 2007 rezulton të jetë pak me shumë se 300 000 ton.


Grafiku 1. Përqindja e mbeturinave të grumbulluara nga „banesat kolektive “ dhe „ derë me derë ” për tërë Kosovën.



* Prishtina, Glogovci, Fushë Kosova, Lipjani & Produjeva


Grafiku 2. Përqindja e mbeturinave të grumbulluar sipas vendit të hedhjes „ Banesat Kolektive “ dhe „ Derë me Derë ” për Prishtinën dhe regjionin e sajë.

Prishtina dhe Regjioni



Grafiku 3. Përqindja e mbeturinave të grumbulluara nga „ banesat kolektive “ dhe „ derë me derë ” për regjionet tjera në Kosovë

Regjionet tjera në Kosovë




Në Kosovë grumbullimi i mbeturinave „ Derë me Derë ” është afërsisht 50 përqind. Por në qoftë se do të krahasohet Prishtina dhe regjioni me pjesën tjetër të Kosovës, mbledhja „ Derë me Derë ” është me dominante në këtë të fundit.

Tabele 2. Sasia e mbetjeve komunale për person grumbulluar në Kosovë ne 2007

Regjioni	Sasia e grumbulluar (1000 ton)	Popullsia ²	Popullsi (kg/banorë)	Mbeturina/ person në ditë (kg/banorë)
Prishtina dhe regjioni ¹	182	500 000	332	0.9
Regjionet tjera në Kosovë	148	1 600 000	95	0,3
Gjithsej	330	2 100 000	157	0.4

Grafiku 4. Sasia e mbetjeve komunale për person grumbulluar në Kosovë në vitin, 2007




¹ Prishtina, Gllloovci, Fushë Kosova, Lipjani & Produjeva.

² Popullsia është llogaritur ne bazë te lindjeve te gjalla, 2007. Publikimi SL, 2007 ESK.

Në Kosovë mbeturinat komunale gjatë vitit, 2007 ishin 157 kg për person. Kjo shifër është e ndryshme në zona të ndryshme. Në Prishtinë dhe regjionin e sajë kjo sasi është 0,9 kg në ditë për person. Për pjesën tjetër të Kosovës kjo sasi është shumë më pak.

Harta e Kosovës



Burimi: ESK

Aneks 1 Pyetësi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shërbimeve Publike - Ministarstva Javnih Sluzbi - Ministry of Public Services

Enti i Statistikës së Kosovës - Zavod za Statistiku Kosova - Statistical Office of Kosovo

P Y E T Ë S O R

Anketa e Mbeturinave Komunale, 2007

Njësitë raportuese – Kompanitë Komunale Publike dhe Private

Pyetësi plotësohet nga të gjitha Kompanitë Komunale Publike dhe private në Republikën e Kosovës

Data referohet periudhës prej 01.01. - 31.12.2007.

Kjo ankete është bazuar ne rregulloren e UNMIK-ut,2001/14, në bazë të cilës ju do të plotësoni informatat e kërkuara. Te dhënat personale janë konfidenciale dhe do te publikohen të grupuara, duke mbrojtur interesin tuaj, nuk do të përdoren për qëllime tjera.

Ju Faleminderit!

TE DHËNAT IDENTIFIKUESE

1.1 KOMPANIA /EMRI _____

1.2 NUMRI I BIZNESIT TE KOMPANISË _____

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

1.3 KOMUNA _____ VENDI _____

1.4 ADRESA _____

TELEFON _____ FAX _____

E-MAIL _____ UEB FAQE _____

Kjo ankete plotësohet nga Drejtori Operativ i Kompanisë

TABELA 1. MBETURINA KOMUNALE TE GRUMBULLUARA, PËRPUNUARA DHE HEDHUR SIPAS KOMPANIVE KOMUNALE PUBLIKE (01.01 – 31.12.2007)

VENDI I GJENERIMIT TË MBETURINAVE

Komuna (emri)	Kodi komunal (plotësuar nga ESK)	Numri i zonave operimi që shfrytzojnë ndërmarrja publike	Sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara sipas vëndit të hedhjes			
			volumi (ton)			
			TOTAL	BK	DMD	
a	1	2	3	4	5	6
01						
02						
03						
04						
05						
06	TOTALI					

- Shënoni ne kolonën 5 mbeturinat e grumbulluara nga banesat kolektive
- Shënoni ne kolonën 6 mbeturinat e grumbulluara dere me dere, vlerëso me 0,2 ton një m³ mbeturine

Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

Enti i Statistikës së Kosovës, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Enti i Statistikës së Kosovës vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

Struktura organizative e ESK-së, katër *Departamente prodhuese* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), *shtatë Zyra Rajonale* (Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), *dy Departamente mbështetëse* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe *Zyra e regjistrimit të popullsisë*, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-ës. Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .

Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare.

Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale.

Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

Misioni i Entit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa:** Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë
- **Telefonat:**
Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111
Drejtori: +381 (0) 38 235 545
- **Fax: +381 (0) 38 235 033**
- **E-mail: agricultural@ks-gov.net**
- **Ueb-faqe: www.ks-gov.net/esk**